



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA GRAMSH

KESHILLI BASHKIAK

KOMISIONI I ARSIMIT, KULTURES, SPORTEVE, DHENIES SE TITUJVE DHE
INFORMIMIT

RAPORT VENDIMARRJE

Nr. 2 Datë 25/08/2025

Lënda: Vendim për shqyrtimin e projekt-vendimit nr.....datë,/...../2025 "Per Miratimin
e Planit te Arsimit Parauniversitar te Bashkise Gramsh, 2026-2028"

Drejtuar: Këshillit Bashkiak Elbasan

Hyrje

Ky projekt-vendim paraqitet nga Drejtoria e Sherbimeve Sociale, dhe ka për qëllim:

BAZUESHMERIA LIGJORE DHE VOTIMI	<i>Ligji 139/2015 "Për Vetqeverisjen Vendore" datë 17.12.2015, i ndryshuar, Rregullores së Pergjithshme te Këshillit Bashkiak dhe Rregullores së Konsultimit Publik. Ky projekt-vendim bazohet në nenin 54 të ligjit 139/2015, pika "k". Votimi që kërkohet është me shumicë thjeshte me 50+1</i>
SITUATA AKTUALE E FUNKSIONIT	<i>Në vitin 2015, gjatë periudhës së ndryshimeve politike në Shqipëri, u ndërmorën reforma të rëndësishme që preknin strukturën e Bashkive në vend. Këto ndryshime organizative sollën krijimin e 61 Bashkive të reja, duke sjellë me vete sfida të shumta administrative dhe organizative. Këto transformime u realizuan në përpjekje për të decentralizuar më tej pushtetin vendor dhe për të përgjigjur më mirë nevojave për zhvillim dhe mirëqenie sociale dhe ekonomike në nivel lokal.</i> <i>Në lidhje me arsimin parauniversitar, Bashkia Gramsh mori përsipër përgjegjësinë për zbatimin dhe përmirësimin e këtij sektori në territorin e saj. Pas një eksperience pune nënte-vjeçare në ofrimin e shërbimit të Arsimit Parauniversitar, tashmë duke njohur mirë nevojat dhe sfidat, Bashkia Gramsh ka punuar ngushtesisht me Shoqaten Kombetare te Bashkive te Shqiperise për një plan të qartë afatmesëm për përmirësimin në vijim të shërbimit për të adresuar nevojat dhe sfidat në arsimin parauniversitar.</i> <i>Në këtë plan, synojmë të ndërtojmë një sistem arsimor parauniversitar cilësor, modern dhe gjithëpërfshirës, që u garanton të gjithë fëmijëve e nxënësve kushte optimale për të mësuar, për t'u rritur dhe për t'u zhvilluar në bashkëpunim me familjen dhe komunitetin. Duke marrë në konsideratë analizat e deritanishme mbi shpërndarjen gjeografike të institucioneve arsimore, kapacitetet e burimeve</i>



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA GRAMSH

KESHILLI BASHKIAK

KOMISIONI I ARSIMIT, KULTURES, SPORTEVE, DHENIES SE TITUJVE DHE INFORMIMIT

njerëzore, boshllëqet në infrastrukturë dhe nivelin e pjesëmarrjes së fëmijëve në arsim, Bashkia Gramsh angazhohet të ndjekë këto qëllime dhe objektiva strategjike.

Qëllimii (Q1). Të garantohet funksionimi i qëndrueshëm, cilësor dhe gjithëpërfshirës institucioneve të arsimit parauniversitar (parashkollor, bazë dhe i mesëm i përgjithshëm) në territorin e bashkisë, duke siguruar kushte optimale për mësimdhënie, mirëgenie dhe zhvillim të fëmijëve dhe nxënësve. mbulimi i plotë me staf arsimor dhe staf të shërbimeve

Objektivi 1.1 Të sigurohet mbështetje, si dhe ofrimi i infrastrukturës së përshtatshme, kushteve higjieno-sanitare, sistemeve të ngrohjes dhe furnizimeve të nevojshme për të gjitha institucionet arsimore në kuadër të garantimit të cilësisë dhe vazhdimësisë së shërbimit.

Objektivi 1.2 Deri në fund të vitit 2028, të realizohet rikonstrukcioni i të paktën një institucioni arsimor 9-vjeçar, të sigurohet pajisja e institucioneve parashkollore me pajisje informatike dhe mjete të tjera didaktike, si dhe të krijohet dhe të përdoret një regjistër digjital i integruar e i përditësuar për kopshtet dhe shkollat, me synim përmirësimin e kushteve të mësimdhënies, rritjen e cilësisë së arsimit, garantimin e aksesit të barabartë për lëmjët dhe rritjen e eficiencës në menaxhim e planifikim afatgjatë të investimeve. **Qëllimi (Q2)** Të garantohet ofrimi i një edukimi parashkollor cilësor dhe gjithëpërfshirës, i bazuar në standarde bashkëkohore të mësimdhënies dhe mbështetjes zhvillimore, përmes fuqizimit të kapaciteteve të stafit edukativ e mbështetës, përdorimit të metodologjive inovative dhe nxitjes së shkëmbimit të praktikave të mira, duke siguruar që çdo fëmijë të ketë mundësi të barabarta për të mësuar, për t'u rritur dhe për t'u zhvilluar.

Objektivi 2.1 Të mitet cilësia e edukimit parashkollor nëpërmjet forcimit të kapaciteteve profesionale të edukatorëve dhe stafit mbështetës, duke promovuar mësimdhënien e orientuar drejt fëmijës, përdorimin e metodologjive bashkëkohore dhe mjeteve didaktike inovative, si dhe shkëmbimin e praktikave të mira për zhvillimin gjithëpërfshirës të fëmijëve.

Objektivi 2.2 Të sigurohet mbështetje gjithëpërfshirëse për fëmijët dhe nxënësit në institucionet arsimore



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GRAMSH
KESHILLI BASHKIAK

KOMISIONI I ARSIMIT, KULTURES, SPORTEVE, DHENIES SE TITUJVE DHE
INFORMIMIT

	përmes angazhimit të mësuesve ndihmës, forcimit të strukturave pjesëmarrëse dhe këshilluese, ofrimit të shërbimeve psiko-sociale, si dhe mbështetjes së fëmijëve nga familjet në nevojë dhe atyre me rezultate të shkëlqyera, duke garantuar akses të barabartë, përfshirje aktive dhe zhvillim të plotë në procesin arsimor. Qëllimi (Q3) Të zhvillohen dhe të institucionalizohen aktivitete të rregullta kulturore, sportive, mjedisore dhe ndërgjegjësuere në të gjitha institucionet arsimore, me pjesëmarrjen aktive të fëmijëve dhe mbështetjen e stafit pedagogjik, prindërve dhe komunitetit, me qëllim axitjen e zhvillimit të përgjithshëm, forcimin e bashkëpunimit shkollë-familje-komunitet dhe promovimin e vierave të diversitetit, solidaritetit dhe përfshirjes sociale. Objektivi 3.1 Të organizohen rregullisht aktivitete kulturore, sportive dhe ndërgjegjësuere (si diitë tematike, ckspozita, aktivitete mjedisore dhe komunitaro), me pjesëmarrjen aktive të fëmijëve dhe mbështetjen e institucioneve arsimore, Qendrës Kulurore të Femijëve "Adem Hoxha" dhe komunitetit, për të nxitur zhvillimin e përgjithshëm dhe integrimin
SITUATA FINANCIARE (Impakti financiar, shtesa pakësime në buxhet)	Te gjitha kostot e planit do te llogariten ne muajt ne vazhdim dhe do te pasqyrohen ne pogramin buxhetor afat-mesem (PBA) 2026-2028. Financimi i planit do të mbështetet në burime të kombinuara nga buxheti vendor, transfertat specifike dhe të pakushtëzuara nga qeveria qendrore, si dhe nga bashkëpunimi me partnerë zhvillimi, organizata dhe donatorë.
DREJTORIA PËRGJEGJËSE	Drejtoria e Sherbimit Social.
RAPORTIMI DHE MONITORIMI	Plani përmban mekanizma të qartë të monitorimit, tregues matës të progresit dhe ndikimit, raportim vjetor, rishikim afatmesëm dhe pjesëmarrje të aktorëve lokalë dhe komunitetit në vlerësim.
IMPAKTI SOCIAL DHE GRUPET QË PREKEN	Plani është shtrirë në të gjitha kopshtet dhe shkollat nën juridiksionin e Bashkisë Gramsh, me qëllim përmirësimin e shërbimit arsimor parauniversitar për të gjithë fëmijët dhe nxenesit në te gjithë territorin e Bashkise Gramsh.
KONSULTIMI PUBLIK	Ky projekt vendim kërkon konsultim publik sipas nenit 17 te ligjit 139/2015, të Rregullores së Këshillit. Eshte marre vendimi i Kryesise per kalimin ne konsultim publik te projektaktit. Eshte hartuar dhe publikuar ne



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
BASHKIA GRAMSH
KESHILLI BASHKIAK

KOMISIONI I ARSIMIT, KULTURES, SPORTEVE, DHENIES SE TITUJVE DHE
INFORMIMIT

	<i>fagen e internetit te Bashkise Gramsh, njoftimi dhe kalendari per degjasat publike. Eshte realizuar nje degjese me publikun date 25.08.2025, ku kane marre pjese persona. Eshte mbajtur procesverbali i takimit dhe kane dale rekomandimet per konsultimin publik te cilat jane permblodhur dhe i jane derguar Kryetarit te Bashkise per reflektim.</i>
--	--

Komisioni i Përhershëm i Arsimit, Kultures, Sporteve, Dhenies se Titujve te Nderit dhe Informimit, i mbledhur më datën 25/08/2025 pasi shqyrtoi Projekt-vendimin Për miratimin e Planit të Arsimit Parauniversitar Bashkia Gramsh 2026-2028, relacionin dhe dokumentat shoqërues të tij, paraqitur nga Kryetari i Bashkisë

Komisioni me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Ti propozojë Këshillit Bashkiak:
 - a. Kalimin e projekt aktit në mbledhjen e këshillit për vlerësim të mëtejshëm për vlerësim dhe miratim.
 - b. Miratimin e projektaktit
 - c. Refuzimin e miratimit të Projektaktit
 - d. Ti kerkoje drejtorise perkatese informacion shtese per projektvendimin
 - e. Miratimin e projektaktit me ndryshimet si vijon:
 - Pika e projektvendimit të ndryshojë në “ _____ ”
 - Pika e projektvendimit të ndryshojë në “ _____ ”
 - Tabela e projektvendimit të ndryshojë në “ _____ ”
 - Paragrafi i projektvendimit të ndryshojë në “ _____ ”

Bashkëlidhur argumentat e Vendimarrjes dhe mendimi i pakicës i parqitur në procesverbalin e Komisionit

Kryetare e Komisionit: Ardiana Hasa

Nenkryetare e Komisionit: Brunilda Gjevori

Sekretare e Komisionit: Valbona Verushi

Gramsh më: 25/08/2025